



Zhvillohet ceremonia e betimit të studentëve të AFA-së

Në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e betimit të studentëve dhe kadetëve të rinj. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, komandantë forcash,

drejtorë, si dhe familjarë e të afërm të studentëve. Në fjalën e tij përshëndetëse, dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Ilirjan Dauti, falënderoi të pranishmit, si dhe familjarët e studentëve për mbështetjen që u kanë dhënë në zgjedhjen e një profesioni kaq të bukur, por plot sfida dhe sakrificë. "Ju sot vini më një status të vlerë, nga një qytetar i zakonshëm

në një ushtarak të devotshëm. Të aftë fizikisht dhe psikologjikisht për të përballuar sfidat që do ju dalin përpara. Të vetëdijshëm se të qenit ushtarak nuk e bën dot çdokush, por ai që ka vullnetin, moralin dhe motivacionin për t'i shërbyer popullit dhe atdheut. Jemi të bindur se rrugën e nisur do ta përfundoni me sukses të plotë. Atdheu... >>> faqe 2




Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Fuqizojmë sigurinë kibernetike, rrisim pagat e ushtarakëve



Gjeneral brigade Kingji: Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në ndihmë të Ukrainës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim ambasadorin ukrainas Volodymyr Shkurov. Pasi i uroi mirëseardhjen, gjeneral brigade Kingji e njohu ambasadorin Shkurov me zhvillimet dhe arritjet më të fundit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Gjatë takimit, gjeneral brigade Kingji e siguroi ambasadorin ukrainas se Shqipëria në bashkëpunim me SHBA-të, vendet anëtare të NATO-s, si dhe ato partnere, do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm duke iu bashkuar çdo nisme dhe...



>>> Faqe 2

Forca Tokësore nis kontingjentin e l shtesë në kuadër të misionit KFOR

30 trupa nga batalioni i Tretë i Këmbëorisë (b3k), u nisën me mision në Pejë, Kosovë, si pjesë e misionit të NATO-s, KFOR. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në ambientet e b3k merrnin pjesë: kryetarja e bashkisë Dimal znj. Juliana Mema, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dima, miq dhe familjarë të efektivave të kontingjentit paqeruajtës etj. Fjala e hapjes u mbajt nga komandanti i b3k, kolonel Gëzim Marku, i cili ndër të tjera theksin e vuri tek eksperiencia e krijuar nga efektivët...



>>> Faqe 4

"Duam të bëhemi 'Zotër' dhe kjo na pengon të bëhemi njerëz"

Sot, më shumë se kurrë është e Snevojshme që njeriu të njohë veten, sepse duket qartë, që ai është i prirur më shumë e më mirë të njohë planetët, trupat qiellorë, teknologjinë, gjërat që janë jashtë tij, gjithçkanë e një bote shumë komplekse, sesa njihjen e unit të vet. E duke mbetur kështu, skllav në rrjetën e merimangës së botës dinamike, që rrotullohet vetëm brenda saj dhe që nuk e lejon njeriun t'i kushtojë rëndësi njohjes së vetes, edhe pse kjo e fundit është shumë e nevojshme dhe e rëndësishme. Njoha e vetes është një...



>>> Faqe 6

Zhvillohet ceremonia e betimit të studentëve të AFA-së

Në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e betimit të studentëve dhe kadetëve të rinj. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes z.Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, komandantë forcash, drejtorë, si dhe familjarë e të afërm të studentëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Ilirjan Dauti, falënderoi të pranishmit, si dhe familjarët e studentëve për mbështetjen që u kanë dhënë në zgjedhjen e një profesioni kaq të bukur, por plot sfida dhe sakrificë. "Ju sot vini më një status të vlerë, nga një qytetar i zakonshëm në një ushtarak të devotshëm. Të aftë fizikisht dhe psikologjikisht për të përballuar sfidat që do ju dalin përpara.

Të vetëdijshëm se të qenit ushtarak nuk e bën dot çdokush, por ai që ka vullnetin, moralin dhe motivacionin për t'i shërbyer popullit dhe atdheut.

Jemi të bindur se rrugën e nisur do ta përfundoni me sukses të plotë.

Atdheu nga sot do të këtë dhe 80 luftëtarë të tjerë, të gatshëm për t'u sakrifikuar për të", - do të mbyllte fjalën e tij kolonel Dauti. Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, në fjalën e tij u shpreh se ishte një kënaqësi krejt e veçantë të ishte i pranishëm në këtë ceremoni, si dhe foli për transparencën dhe meritokracinë gjatë procesit të përzgjedhjes mes shumë kandidatëve të tjerë.

"Para tre muajsh, falë rezultateve dhe meritave tuaja, u përzgjedhët për t'iu bashkuar Forcave tona të Armatosura. Nderi, Detyra, Atdheu



janë pasaporta juaj morale me të cilën do të përfaqësoni denjësisht kombin shqiptar ku do t'ju thërrasë detyra", - u shpreh z. Peleshi, i cili nuk la pa përmendur sfidat me të cilat studentët dhe kadetët e rinj do të përballen. "Në të ardhmen, një pjesë e mirë e juaja do të kenë mundësinë për të shërbyer

në angazhimet dhe operacionet jashtë vendit, për të cilat jam i bindur që, ashtu si dhe paraardhësit tuaj, do të lini gjurmët tuaja të lavdisë".

Në fund të fjalës së tij, ministri Peleshi përmendi edhe një herë punën dhe përkushtimin e kuadrove dhe gjithë efektivit jo vetëm për stërvitjen, por

edhe për përmirësimin e kushteve të punës, stërvitjes, jetesës dhe i siguroi se mbështetja e tij personale apo e Ministrisë së Mbrojtjes do të jetë e vijueshme, jo vetëm për këtë strukturë, por për të gjithë Forcat e Armatosura.

"Politikat mbështetëse të Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për mo-

ktivimin mbështetjen, përkujdesjen, modernizimin, dhe arsimimin cilësor me pikësynim arritjen e standardit të akademisë "West Point", do jenë fokus kryesor për vazhdimësinë".

Në fund të ceremonisë studentë dhe kadetë bënë betimin e tyre nën flamurin shqiptar.

SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji: Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm, duke iu bashkuar çdo nisme dhe kontributi në ndihmë të Ukrainës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim ambasadorin ukrainas Volodymyr Shkurov. Pasi i uroi mirëseardhjen, gjeneral brigade Kingji e njohu ambasadorin Shkurov me zhvillimet dhe arritjet më të fundit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë takimit, gjeneral brigade Kingji e siguroi ambasadorin ukrainas se Shqipëria në bashkëpunim me SHBA-të, vendet anëtare të NATO-s, si dhe ato partnere, do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm duke iu bashkuar çdo nisme dhe kontributi në ndihmë të Ukrainës.

Nga ana e tij, ambasadori Shkurov shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm mes dy vendeve,



duke falënderuar për ndihmën që Forcat e Armatosura dhe Shqipëria kanë dhënë dhe do japin në ndihmë të ushtrisë dhe popullit ukrainas në këtë situatë mjaft të vështirë dhe

kritike për vendin e tij.

Të dy bashkëbiseduesit shprehën besimin dhe dëshirën e vijimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve.

Stërvitja "Defender Europe-23"



SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji, në kuadër të përgatitjeve për stërvitjet "Defender Europe-23", "Strong Balkan-23, vizitoi ambientet e Komandës së Forcës Tokësore dhe Regjimentit të Operacioneve Speciale. Si dhe ecurinë e procesit të punimeve mbi përmirësimin e infrastrukturës stërvitore dhe akomoduese. Gjeneral brigade Arben Kingji u ofroi strukturave përgjegjëse gjithë mbështetjen e tij për realizimin me sukses të këtyre stërvitjeve me vlerë të madhe për ushtrinë shqiptare.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji dhe drejtori i Përgjithshëm AKMC, Haki Çako, prezantuan në një konferencë për mediat arritjet gjatë vitit 2022 si dhe objektivat e projektet e reja për vitin 2023 në fushën e Mbrojtjes si edhe të Mbrojtjes Civile.

Sipas ministrit Peleshi, në 2022 nisi puna për ndërtimin e Bazës Taktike ajrore të NATO në Kuçovë. Ministri theksoi se kjo është e para bazë ajrore e NATO-s dhe jo pa qëllim është zgjedhur Shqipëria. “Shqipëria ka pozicion strategjik në Ballkanin Perëndimor, por është edhe vend aleat i NATO-s, i sigurt, i qartë në orientimin e vet edhe ka një rol të rëndësishëm për të luajtur edhe në vendet ku jetojnë shqiptarë: në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, por edhe vende të tjera”, - tha Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes deklaroi se gjatë 2022 përfundoi faza e parë e projektit të komunikimit Tokë - Ajër - Tokë (GAG) si dhe u nënshkrua marrëveshja për shtimin e flotës ajrore me avionë luftarakë pa pilotë me kompaninë turke “Baykar Technologies”.

“Dronët ‘Bayraktar’ kanë reputacion, pasi kanë provuar të jenë të suksesshëm në kuptimin e aftësisë së tyre mbrojtëse ushtarake, por ne do t’i përdorim ato edhe për qëllime civile, madje shpresojmë të mos i përdorim për qëllime të tilla. Të kombinuar edhe me shërbimet satelitore do të na japin një potencial të jashtëzakonshëm, i cili ka nevojë të dijë vetëm të përdoret”, - tha Peleshi.

Sa i përket satelitëve “Albania 1” dhe “Albania 2”, Peleshi tha se imazhet që do sigurohen prej tyre do të kontribuojnë në shumë elementë.

“Shërbimet satelitore mund të jenë edhe komerciale në kuptimin që t’iu vendosen në dispozicion për shembull fermave bujqësore, por edhe operatorëve të tjerë që kanë nevojë për imazheri të saktë satelitore”, - tha ministri Peleshi.

“Satelitët japin informacionin. Ju siguroj që satelitët do jenë një mjet i rëndësishëm për t’u përdorur nga institucione e Policisë së Shtetit. Kur investon në teknologji investon për të kursyer. Janë kursim kohe dhe parash. Ne kemi një agjenci shtetërore që kanë bërë një punë fantastike. Këto dy kapacitete do jenë vlerë e shtuar, por edhe kursim parash për buxhetin e shtetit”, - deklaroi Peleshi.

Gjithashtu, ministri tha se “Forcat e Armatosura do të kenë pjesë të saj sistemin raketor antitank “Javelin” dhe



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Fuqizojmë sigurinë kibernetike, rrisim pagat e ushtarakëve



por për specialistët e fushës së IT-së dhe Sigurisë Kibernetike po aplikon një regjim të veçantë fleksibël dhe kompetitiv”, - nënvizoi Peleshi.

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2023 do t’iu kushtohet edhe Emergjencave Civile, pas investimeve që u kryen gjatë vitit 2022. Dy avionë dhe mjete të posaçme për Mbrojtjen Civile do i shtohen vendit tonë me anë të kredisë me vlerë 30 milion euro pas marrëveshjes me Italinë, sipas ministrit Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se Shqipëria do të rrisë kontributin e saj në misionet jashtë vendit, ndërsa theksoi mbështetjen materiale dhe politike për Ukrainën.

atë kundërajror “Stinger”.

Ministri i Mbrojtjes nënvizoi faktin se gjatë vitit 2022 pagat e ushtarakëve u rritën në masën 30%, duke theksuar se rritja do të vijojë edhe gjatë vitit 2023 me 7% për të gjitha gradat, ndërsa njoftoi edhe implementimin e paketës sociale për ushtarakët.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi thotë se këtë vit do t’i jepet më shumë prioritet fushës së sigurisë kibernetike. Ai tha gjatë konferencës për

shtyp se këtë vit do të ndërtohet qendra operacionale e fushës kibernetike. Ministri Peleshi u shpreh se: “2023 do të jetë viti kur njësia ushtarake e Mbrojtjes Kibernetike do të ketë plotësuar 100% kapacitetet e veta njerëzore. Jemi në një proces rekrutimesh, kemi ndryshuar strukturën; kemi trefishuar numrin e kapaciteteve në strukturë; kemi rritur pagat, i kemi bërë fleksibël, pasi ju e dini: burokracia shtetërore nuk të lejon të dalësh nga kategoritë e pagave të caktuara,



Forca Tokësore nis kontingjentin e I shtesë në kuadër të misionit KFOR

30 trupa nga batalioni i Tretë i Këmbësorisë (b3k), u nisën me mision në Pejë, Kosovë, si pjesë e misionit të NATO-s, KFOR.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në ambientet e b3k merrnin pjesë: kryetarja e bashkisë Dimal znj. Juliana Mema, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, miq dhe familjarë të efektivave të kontingjentit paqeruajtës etj. Fjala e hapjes u mbajt nga komandanti i b3k, kolonel Gëzim Marku, i cili ndër të tjera theksin e vuri tek eksperiencia e krijuar nga efektivët e b3k ndër vite, për sa i takon pjesëmarrjes në operacione paqeruajtëse. Është kjo eksperiencë, por edhe trajnimi i vijueshëm që kryhet në këtë repart ato që sipas kolonel Markut, e mbushin me besim se ky mision do të jetë i suksesshëm, ashtu si edhe misionet paraardhëse.

Të pranishmit, i përshëndeti në emër të kontingjentit komandanti i këtyre efektivëve, major Mariglen Tomani, i cili, pasi falënderoi eprorët për besimin e treguar, i siguroi ata se misionin që iu është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe profesionalizëm.

Duke marrë fjalën në ceremoni, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore gjeneral Dimo ndër të tjera tha: "...sot është një ditë e veçantë dhe kuptimplotë. Ceremonia e sotme, i bashkohet dhjetëra ceremonive të organizuara me raste të tilla nga Forca Tokësore, jo vetëm për të përcjellë,



por edhe të për të nderuar dhe respektuar djemtë dhe vajzat e saj më të mirë nën uniformë. Misioni, ku ju shkonit sot është një mision në shërbim të paqes dhe sigurisë. Ju do jeni ambasadorët tanë më të mirë në rajon. Mbajeni lart flamurin tonë kombëtar dhe emrin

shqiptar, duke treguar çdo ditë nivelin tuaj profesional në bashkëveprim me aleatët. Qëndroni përkrah njëri-tjetrit, në çdo situatë dhe në çdo nevojë...."

Në mbyllje të fjalës së tij, gjeneral Dimo i siguroi familjarët e paqeruajtësve të kontingjentit I shtesë me

mision në Kosovë, se Forca Tokësore, por edhe Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes do të jenë gjithmonë në kontakt me ta dhe pranë tyre, për çdo problem apo nevojë që do të kenë.

Kontingjenti I shtesë, përbëhet nga një togë e efektivëve të batalionit të

Tretë të Këmbësorisë dhe do t'i bashkohet trupave të kontingjentit të Forcës Tokësore që ndodhen aktualisht në Pejë, Kosovë në kuadër të misionit KFOR.

Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale.

Kursi "Komando", konsiderohet si një nga kurset më të vështira, që zhvillohet në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS). Për mbi 72 orë, kandidatët për beretën blu iu nënshtruan stërvitjes komplekse në rajonin e Fekenit, ku testuan aftësitë dhe rezistencën e tyre psiko-fizike.



Nisën rrugëtimin për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë të rinjtë dhe të rejat që u përzgjedhën në testimin përfundimtar që u zhvillua pranë Qendrës së Personel Rekrutimit. Rekrutët e rinj u përshëndetën nga komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, Kolonel Altin Gjetaj, si dhe në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura përshëndeti drejtori i Shtabit, kolonel Arben Zani.



Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia: Privilegj që kjo shkollë mban emrin e heroit tonë Klodian Tanushi

Në shkollën 9 - vjeçare në Qesarakë, e cila mban emrin e Dëshmorit të Atdheut Klodian Tanushi, u bë inaugurimi i muzeut të shkollës. Në ambientet e kësaj shkolle është bërë gjithashtu dhe dhurimi i librave për bibliotekën e shkollës nga dhurues të ndryshëm.

Në këtë ceremoni morën pjesë familjarë të dëshmorit të atdheut Klodian Tanushi, deputetë të zonës, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia si dhe përfaqësues nga Batalioni i Xhenios të Komandës Mbështetëse.

Hapja e ceremonisë nisi me përshëndetjen e drejtorit të shkollës, i cili mirëpriti të gjithë të pranishmit dhe falënderoi shoqatën 'Lidhja e Intelektualëve dibranë' për kontributin e dhënë për shkollën "Klodian Tanushi" dhe veçanërisht për 400 librat e dhuruar për bibliotekën e kësaj shkolle, si

dhe për krijimin e muzeut të shkollës, falënderoi familjen e Klodianit. Më pas fjalën e mori z. Shpëtim Cani, ku u shpreh se dhurimi i këtyre librave është simboli i përjetësisë së heroit dhe i trashëgimisë arsimdashëse të një krahine si Dibra, ku ndiejmë përgjegjësinë që këtë traditë t'ua transmetojmë brezave të rinj. Edhe babai i Klodianit, z. Basri i falënderoi të gjithë për angazhimin dhe përkushtimin ndaj veprimtarisë kushtuar Klodian Tanushit. Ai u shpreh se "Klodianit nuk është vetëm i imi, por i gjithë Dibrës dhe i mbarë popullit shqiptar".

Në emër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, të pranishmit u përshëndetën nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, i cili theksoi se: "Ndjehemi të privilegjuar që kjo shkollë do mbajë emrin e heroit tonë Klodian Tanushi.



Vetëm pak ditë pas dislokimit të tyre në Camp "Villaggio Italia", në Pejë, Kosovë, trupat e kontingjentit I shtesë në misionin KFOR, i nënshtrohen trajnimit "Fire Phobia" me synim rritjen e aftësive operacionale.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Duam të bëhemi ‘Zotër’ dhe kjo na pengon të bëhemi njerëz”

Sot, më shumë se kurrë është e nevojshme që njeriu të njohë veten, sepse duket qartë, që ai është i prirur më shumë e më mirë të njohë planetët, trupat qiellorë, teknologjinë, gjërat që janë jashtë tij, gjithçkanë e një bote shumë komplekse, sesa njohjen e unit të vet. E duke mbetur kështu, skillav në rrjetën e merimangës së botës dinamike, që rrotullohet vetëm brenda saj dhe që nuk e lejon njeriun t’i kushtojë rëndësi njohjes së vetes, edhe pse kjo e fundit është shumë e nevojshme dhe e rëndësishme.

Njoha e vetes është një art më vete dhe, siç e dimë, për të krijuar një art të mirë kërkohet kohë, vullnet, angazhim e gjithashtu edhe mjete ose ngjyra.

Kjo nuk mund të arrihet për një kohë të shkurtër, e po ashtu, nuk mund të bëhet vetëm pa përfshirë tjetrin. Gjithashtu për të njohur më mirë dhe për të kuptuar se kush jemi, kërkohet edhe një element tjetër që t’i tregojmë vetes historinë tonë. Sepse, ajo nuk arrihet duke lexuar libra psikologjikë, filozofikë, ose portale të ndryshëm, por duke e lejuar veten që të ndihmohemi nga të tjerët.

Njeriu sado që të mundohet ta njohë veten e tij, ajo mbetet e panjohur për të. Njeriu ka për detyrë ta njohë veten e ta kërkojë të vërtetën, ai nuk mund të mbesë human në qoftë se nuk ia arrin kësaj detyre. Pra, kërkohet që ai të jetë në gjendje të dallojë të mirën dhe të keqen, të mësojë të dëgjojë zërin e ndërgjegjes, zërin e brendshëm dhe të jetë i aftë që ta ndjekë këtë zë të brendshëm të zemrës së tij e ta pranojë të vërtetën edhe nëse është e pa këndshme.

Shkaku i madh i sëmundjeve të shumta psikologjike është mosnjohja e vetvetes ose frika e njohjes së vetes, frika e njohjes së emocioneve, impulseve, kujtimeve, aftësive e mundësive. Sepse, njohja e vetes ka të bëjë me marrjen parasysh, jo vetëm të anës më të mirë të vetvetes, por edhe me anën e kufizimeve.

Sipas psikologëve, njeriu ka në vete gjashtë vetë të ndryshëm: njeriu që jemi; njeriu që mendojmë se jemi; njeriu që të tjerët mendojnë se jemi; njeriu që mendojmë se të tjerët mendojnë se jemi; njeriu që duam të bëhemi dhe njeriu që mendojmë se të tjerët duan të bëhemi.

Të jesh vetvetja, të jesh original dhe të afirmosh çdo ditë unicitetin vetjak

Është thelbësore që të mos biem në kurrizin e maskave dhe në artin e kamuflimit, i cili në të vërtetë na bën pafundësisht të palumtur.

Por të jesh vetvetja nuk është e thjeshtë. Sidomos sepse jemi mësuar që të vegjël të ndjekim rregulla precize: duke u sjellë në njëfarë rregulli, duke u përgjigjur në një mënyrë të caktuar, duke u shfaqur mirëkuptues edhe kur nuk biem dakord me dikë, duke kamufluar defektet për t’i pëlqyer më shumë dikujt, si dhe një sërë sjelljesh që na kanë mësuar vetëm “sepse kështu duhet”.

Duke u rritur, mendojmë më shumë për shoqërinë, nëpërmjet me-



diave e marketingut, të cilat na thonë se në ç’ mënyrë duhet të vishemi, çfarë muzike duhet të dëgjojmë, çfarë duhet të hamë dhe të gjitha tendencat e ndryshme që duhet të ndjekim që të jemi në një hap me kohën. Rezultati është: hyjmë të gjithë të bëjmë pjesë në një tufë, të cilën e ndjekim nga pas me kujdes nga frika e mospranimit. Por, në të gjithë këtë “ne”, me mendimet tona, defektet tona, opinionet tona, aftësitë tona, me natyrën tonë të vërtetë... ku jemi?

Reflektojmë mbi gjendjen aktuale, sa prej nesh ndihen si kukulla në duart e dikujt tjetër? Besoj se shumë njerëz gjenden, të vetëdijshëm ose jo, në këtë situatë.

Mendojmë për të gjitha kënaqësitë që marrim kur bëjmë diçka me vullnetin maksimal, apo kur ndihemi të lirë të shprehim mendimin, pa pasur frikën e gjykimit të të tjerëve.

Unë apo ‘uni’?!

Njohja e vetvetes është shtylla e të gjitha virtuteve. Nuk mund të jesh vetvetja nëse nuk di se si je. Ndaj është e nevojshme të dimë se kush jemi, çfarë duam,

Të gjithë kemi një lloj “sinjalizuesi të brendshëm”, i cili në çdo rast e di se çfarë është më mirë për ne. Të shkosh kundër intuitës është njësoj si të mohosh natyrën. Ndaj, bëni gjithmonë atë që ju thotë zemra dhe bëni atë që është më e mira për ju.

Shumë njerëz mundohen me çdo kusht të imitojnë dikë, një të njohur, një mik, një familjar apo, më keq akoma, një personazh publik. Kjo sepse është më e thjeshtë të imitosh të tjerët se sa të punosh mbi zhvillimin e afirmimin e personalitetit personal. Kur mundohemi

të imitojmë dikë, jo vetëm humbasim një sasi të madhe kohe, por rezultatet që marrim janë vetëm zhgënjim e frustrim, pasi nuk ia dalim të jemi ashtu siç duam. Nga ana tjetër, afirmimi i vetes, duke kultivuar një stil personal e jetuar sipas shijeve na bën origjinalë e gjenuinë, si dhe më interesantë në sytë e të tjerëve.

Gjykimi i të tjerëve ndonjëherë mund të rëndojë shumë. Sigurisht, njerëzit janë gjithmonë të gatshëm të shprehin mendimin e tyre (edhe nëse shpesh nuk u kërkohet) dhe të japin këshilla sesi duhet të silleni.

Në çfarë mase të tjerët mund ta dinë atë që është më e mira për ju?

Kur zgjedh një rrugë, atë që mendon se është e duhura, mendimet e të tjerëve pak rëndësi kanë, për të mos thënë fare. Për të qenë vetvetja është e rëndësishme të besoni në zgjedhjet tuaja dhe të mos i hyni një rrugë vetëm për të mos zhgënjyer njerëzit që janë pranë jush. Jini të sigurt për veten, për aftësitë tuaja dhe talentin që keni. Braktisni të gjitha pasiguritë që ju transmetojnë të tjerët. Vetëm kjo ju lejon të jetoni mirë, pa pasur peshën shtypëse se çfarë të tjerët mendojnë për ju.

Në një shoqëri ku pjesa më e madhe e njerëzve kanë tendencën të uniformohen me masën, origjinaliteti është virtyti tashmë pothuajse i rrallë. Shumë shpesh të jemi origjinalë është një çështje kuraje, sepse do të thotë të dallohem i të diferencohemi nga të tjerët, të jemi të ekspozuar më shumë ndaj gjykimeve të tyre.

Të jeni origjinalë, veç të tjerash, do të thotë edhe të ekspozoheni dhe të rrezikoni, sepse të jesh “delja e zezë” jo gjithmonë shihet me sy të mirë dhe është për këtë arsye që rrezikoni të

përfshihen për shkak të “diversitetit”.

Po a është realisht e rrezikshme kjo gjë?

Më e rrezikshme, në fakt, është të ndrydhni kreativitetin tuaj, vetëm nga frika se mos nuk ju kuptojnë dhe ju paragjykojnë.

Nëse hidhni shikimin rreth e qark, mund të vini re që njerëzit që kanë pasur kurajën të diferencohen, janë ata që në rrjedhën e kohës kanë marrë edhe më shumë kënaqësi nga jeta, sepse kanë mundur të shprehin deri në fund atë potencial kreativ, që shumë nuk kanë pasur kurajën ta shfaqin.

Shumë njerëz nuk janë të mësuar të mendojnë vetë dhe të vënë në dyshim ato që shohin, lexojnë apo dëgjojnë. Kështu, shpesh njerëzit pranojnë verbërisht çdo gjë pa pasur një mendim të vetin. Të kesh një mendim personal dhe të keni një qëndrim tuajin, është thelbësore për të qenë vetvetja. Kush mendon me kokën e vet ka aftësinë që t’i shohë gjërat nën këndvështrim të ndryshme dhe të ndryshojë perspektivën, të kërkojë zgjidhje të tjera, të vlerësojë nëse për çdo gjë ekziston një tjetër mundësi, një alternativë më efikase.

Për të qenë vetvetja, nuk ka nevojë të tradhtosh mendimin tënd, por të shprehësh gjithmonë lirshëm dhe me ndershmëri. Kjo do të thotë, të jeni i sqertë në thëniet tuaja dhe të mos fshiheni asnjëherë pas gënjeshtrave për t’u dukur më mirë në sytë e të tjerëve. Shumë shpesh kemi tendencën të gënjejmë edhe për mirësjellje, pasi mbase kemi frikë të ofendojmë dikë.

Të jeni të sqertë me të tjerët është thelbësore, por të jeni me veten tuaj, është edhe më e rëndësishme

Duhet të jeni gjithmonë objektivë

dhe realistë në atë që bëni dhe mendoni. Duke u fshehur pas iluzioneve e justifikimeve, nuk do të mund të jeni asnjëherë vetvetja. Të vendosni të jeni vetvetja, ashtu si në të gjitha ndryshimet e tjera të jetës, kërkoni të bëni zgjedhje të vetëdijshme, por edhe të keni kurajë të madhe. Në këndvështrimin personal, shpërblimi do të jetë shumë i kënaqshëm.

Të gjitha shkencat, vetëm sa i falin njeriut njohuri në lidhje me natyrën dhe e bëjnë atë më të fuqishëm përballë saj.

Misioni më i shenjtë, më urgjent dhe më primar i shkencës duhet të jetë njohja e njeriut. Sepse përpara se t’i bëjmë një shtëpi dikujt, duhet ta dimë se çfarë njeriu është ai. Duhet të dimë përse dëshiron të jetojë atje, ç’ person është, ç’ dëshira ka etj. S’ka kuptim t’i bësh shtëpi një njeriu pa i ditur këto.

Për fat të keq, vetë humanët u përpoqëm të krijojmë një civilizim, një jetë luksoze, përpara se ta njihim më parë vetë qenësinë e tyre. Një civilizim i tillë, edhe përkundër madhësisë dhe luksit që ka, mund të shkaktojë degjenerim tek njeriu, për shkak të mosnjohjes së njeriut, mosnjohjes së qëllimit të tij dhe të kuptimit të të jetuarit.

Unë me një ton optimist them se “mund të degjenerohet” njeriu. Mirëpo një mendimtar realist, i cili jeton në këtë “shtëpi”, nuk do të thoshte se “mund të degjenerohet” por se “është degjeneruar” tashmë.

Miti i ‘narcisit’ tanimë ka fytyrë, trajtë, gjini.

Jam uni im, i pakontestueshëm, i yti, i juaji po ashtu.

Kjo është e vërteta jonë boshe!

Historia e 5 qyteteve që u zhdukën pa lënë gjurmë

Burimet historike janë të mbushura me përmendje të vendeve si Tanis, Helike dhe Roanoke, por arkeologët janë ende në kërkim të vendndodhjeve të tyre të sakta. Historitë që ata po mbledhin së bashku janë të habitshme.

Athina, Teba, Roma dhe qytete të tjera të mëdha lanë pas prova të dominimit të tyre kulturor, arsimor dhe politik në strukturat dhe artefaktet që ekzistojnë deri më sot. Por ka qytetërimi të tjera historike që gjithashtu përparuan - e më pas u avulluan. Një ish-kryeqytet i dinastive egjiptiane, një qendër fetare dhe kulturore greke, pikëmbështetja e parë angleze në kontinentin amerikan, dhe më shumë - të gjitha të zhdukura, pa lënë gjurmë. Legjendat rrotulloheshin për shekuj rreth ekzistencës së tyre, deri relativisht kohët e fundit, kur arkeologët filluan të zbulonin sekretet e tyre të humbura prej kohësh. Pak nga pak, historitë e tyre të pakapshme po shfaqen.

Katër qytete të humbura ishin xhevahire të Afrikës së lashtë. Çfarë ndodhi me ta?

Metropolet pjellore në Luginën e Indus

Qytetërimi i Luginës Indus, i barabartë në fuqi me Mesopotaminë dhe Egjiptin, mbretëroi rreth vitit 2500 p.e.s. dhe 1700 p.e.s. në atë që tani është kryesisht Pakistani në nënkontinentin Indian. Mesopotamia dhe Egjipti evoluan me kalimin e kohës, duke u bashkuar me kulturat e tjera. Por qytetërimi i Luginës së Indus, më i madhi nga të tre, u shemb dhe u zhduk. Askush



nuk e di pse.


Njerëzit e Luginës Indus përfituan nga tokat shumë pjellore të fushës së përmytjes së lumit Indus dhe tregtia nga Mesopotamia e afërt. Dy qytete, Harappa dhe Mohenjo-Daro, dikur shtëpia e 40 000 deri në 50 000 njerëzve, dëshmuar për sofistikimin dhe planifikimin e tyre qendror. Ata ishin bujq, tregtarë dhe zejtarë. Kultura ishte e shkolluar, me një skenar të përpunuar që mbetet kryesisht i pa deshifruar. Risitë e rëndësishme përfshinin peshat dhe masat e standardizuara dhe gdhendjen e vulave në gurë.

Rivale me Egjiptin, mbretëria nubiane e Kushit nxirrte fuqi dhe ar

Një qytetërim i tillë dukej i prirur të përhapej nëpër rajonet pjellore përreth tij. Megjithatë, rreth vitit 1900 p.e.s., pushtuesit fshinë qytetin e madh të Mohenjo-Daro dhe, sipas sedimentit të lumit të analizuar së fundmi në Detin Arabik, musonët e rëndë gjatë një ngrirjeje në Arktik mund ta kenë çuar qytetërimin në kodra. Arkeologët vazhdojnë të gërmojnë, duke kërkuar të dhëna për të bashkuar historinë e kësaj kulture misterioze.

Një kryeqytet egjiptian dhe qendër tregtare e lulëzuar

Pasuritë e zbuluara nga qyteti antik i Tanis, i vendosur në deltën e Nilit në verilindje të Kajros, përfshijnë një kompleks



varresh mbretëror të mbushur me maska ari, bizhuteri, arkivole argjendi dhe thesare të tjera që rivalizojnë ato të mbretit Tut. E megjithatë, pak njerëz kanë dëgjuar për këtë vend spektakolar arkeologjik. Lexuesit e Dhiatës së Vjetër mund ta njohin atë si Zoan, ku thuhej se Moisiu bënte mrekulli. Sot quhet San el-Hagar, një qytet i vogël, i qetë.

Por në atë kohë, qyteti historik i Tanis mbretëroi si kryeqyteti i Egjiptit të dinastisë së 21-të dhe një qendër e pasur tregtare shumë kohë përpara ngritjes së Aleksandrisë. Dhe më pas u zhduk nën rërë kur lumi ndryshoi rrjedhën e tij.

Historia e vërtetë e "qytetit të humbur" të bërë të famshëm nga Indiana Jones

Hetuesit evropianë filluan të zbulonin pjesë të qytetit në shekullin e 19-të, por gjetjet më spektakolare erdhën në vitin 1939, kur arkeologu francez Pierre Montet zbuloi një kompleks varresh mbretëror që përfshinte tre dhoma varrimi të paprekura dhe të patrazuara. Mjerisht, Lufta e Dytë Botërore ndërhyri dhe eklipsoi zbulimet e tij. Megjithatë disa nga thesaret e Tanis tani mund të gjenden në Muzeun Egjiptian të Kajros dhe një liqen i shenjtë kushtuar perëndeshës Mut u vendos në vitin 2009, shkencëtarët e dinë se ka më shumë për të zbuluar. Imazhet satelitore infra të kuqe zbulojnë më shumë ndërtesa që presin të zbulohen.

Një qytet-shtet grek me ndikim

Qyteti-shtet i lashtë grek Helike sundonte si një qendër e rëndësishme ekonomike, kulturore dhe fetare. I renditur ndër aleatët e Agamemnonit në Iliadën, në shekullin e katërt p.e.s. ajo udhëhoqi ligën akeane, një konfederatë mbrojtëse e qyteteve (përfshirë Aigon, që ekziston edhe sot). Ajo madje krijoi koloni, duke përfshirë Sybaris, në Italinë jugore.

Sipas historianëve klasikë, në vitin 373 p.e.s. Helike pësoi një katastrofë. Thuhet se për pesë ditë, gjarpërinjtë, minjtë dhe krijesat e tjera e braktisën qytetin për në zona më të larta; më pas, një tërmet goditi, qyteti ra në tokë dhe oqeani e lau atë, duke vrarë të gjithë banorët.

Këta popuj të lashtë ishin novatorët e kohës së tyre

Qyteti i zhdukur u zbeh në legjendë, vendndodhja e tij e saktë nuk dihet. Shumë eksplorues të shekullit të 19-të dhe të 20-të, duke përfshirë Zhak Yves Kusto, e kërkuar atë më kot në ujërat e Gjirit të Korinthit. Në vitin 2001, një ekip arkeologjik e ktheu vëmendjen e tij në brendësi të deltës së formuar nga lumenjtë që derdhen në gji. Aty e gjetën më në fund: shekulli i katërt p.e.s. mure, monedha dhe qeramikë të varrosura nën baltë shekullore. Qyteti i humbur prej kohësh, një frymëzim i mundshëm për përrallën e Atlantidës, ishte shfaqur edhe një herë. Gërmimet vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Qyteti legjendar i artë

Eksploruesit spanjollë në Amerikën e Jugut dëgjuan për legjendën e El Dorado në vitet 1500. Diku në Ande, u thanë atyre, se njerëzit indigjenë të Muisca vunë një prijë të ri duke e pluhurosuar me ar nga koka te këmbët dhe duke hedhur ar dhe smerald në një liqen të shenjtë. Shefi njihej si El Dorado, i Artë. Të pushtuar nga lakmia, aventurierë spanjollë, gjermanë, portugezë dhe anglezë u futën në egërsitë e pafalshme të Kolumbisë, Guajanës dhe Brazilit - dhe kudo tjetër që dukej premtuese - në kërkim të këtij thesari mitik, duke vuajtur nga kafshimet e gjarpërinjve, sëmundjet dhe vdekjen nga uria. Me kalimin e kohës, El Dorado u shndërrua nga një burrë, në një qytet, në një luginë të shtruar me ar, vetëm në pritje të zbulimit. Asnjë truall i artë nuk u gjet kurrë.

Këto 5 qytete të lashta dikur sundonin Amerikën e Veriut - çfarë ndodhi me ta?

Megjithatë, legjenda mund të ketë disa të vërteta. Liqeni i përmendur në historinë e Muisca-s mund të jetë Laguna Guatavita, lart në Ande afër Bogotas, Kolumbi. Disa objekte ari dhe xhevahire janë nxjerrë nga ai ujë dhe një tjetër aty pranë, por përpjekjet për të kulluar liqenin dhe për të rimarrë pasuritë e njohura kanë dështuar. Çfarëdo thesari të mbytet aty mbetet i patrazuar.

Një koloni e humbur fatkeqe

Në gusht 1587, një grup prej rreth 115 kolonësh anglezë zbarkuan në ishullin Roanoke, në brigjet e asaj që tani është Karolina e Veriut. Ata udhëhiqeshin nga guvernatori kolonial John White, dhe përfshinin djalin e tij, nusen dhe në fund mbesën Virginia Dare, fëmija i parë anglez i lindur në Amerikë. Disa muaj më vonë, White lundroi në Angli për furnizime. Kur më në fund u kthye tre vjet më vonë, askush nuk ishte aty. Nuk kishte asnjë gjurmë të një lufte - të dhënat e vetme ishin fjalët "kroate" dhe "Cro" të gdhendura në një shtyllë druri dhe një pemë. Kolonistët e humbur nuk u gjetën kurrë.

Zbulimi i vitit 2012 i një harte të zonës "Virginea Pars" të vizatuar nga John White zbuloi planet për një fortesë sekrete në fund të Albemarle Sound, 50 milje në perëndim të Roanoke. Atje, në dy vende të vendosura dy milje larg njëra-tjetrës, studiuesit zbuluan një grumbull artefaktesh evropiane pranë fshatit të Amerikës vendase Mettaquem, të cilat përbëjnë një rast bindës të përkatësisë në koloninë e zhdukur të vitit 1587.

Kampi i të mbijetuarve të sapogjetur mund të shpjegojë fatin e kolonisë së famshme të humbur të Roanoke

Vetëm pak kohë më parë, një arkeolog pretendoi se kishte gjetur artefakte të lidhura me kolonistët e zhdukur në ishullin modern Hatteras, rreth 50 milje në jug të Roanoke - ishulli i atëhershëm kroat, shtëpia e fisit kroat, ku ata mund të ishin strehuar. Gjetjet përfshijnë një dorezë shpate, lojë me birila të thyera angleze dhe një fragment të një pllake shkrimi me rrasa të gdhendur ende me një shkronjë. Kolonia e parë "e humbur" e Amerikës mund të jetë ndarë dhe asimiluar në fshatra indigjene. Arkeologët vazhdojnë të kërkojnë në dhëna.



Deklarata e Tretë e Përbashkët e Bashkëpunimit NATO-BE

Presidenti i Këshillit Evropian, Presidenti i Komisionit Evropian dhe Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, nënshkruan Deklaratën e tretë të Përbashkët për Bashkëpunimin NATO-BE

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, dhe Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, më 10 janar 2023, nënshkruan në selinë e NATO-s në Bruksel Deklaratën e tretë të Përbashkët për Bashkëpunimin NATO-BE.

1. Partneriteti strategjik NATO-BE bazohet në vlerat tona të përbashkëta, në vendosmërinë tonë për të trajtuar sfidat e përbashkëta dhe në angazhimin tonë të qartë për të promovuar dhe ruajtur paqen, lirinë dhe prosperitetin në zonën euro-atlantike.

2. Sot, ne jemi përballur me kërcënimin më të madh për sigurinë euroatlantike në dekada. Lufta brutale e Rusisë ndaj Ukrainës shkel ligjin ndërkombëtar dhe parimet e Kartës së OKB-së. Ai minon sigurinë dhe stabilitetin evropian dhe global. Lufta e Rusisë ka përkeqësuar një krizë ushqimore dhe energjetike, duke prekur miliarda njerëz në mbarë botën.

3. Ne dënojmë në termat më të ashpër të mundshëm agresionin e Rusisë. Rusia duhet të ndalojë menjëherë këtë luftë dhe të tërhiqet nga Ukraina. Ne shprehim solidaritetin tonë të plotë me Ukrainën dhe përsërisim mbështetjen tonë të palëkundur dhe të vazhdueshme për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të saj brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht. Ne mbështesim plotësisht të drejtën e natyrshme të Ukrainës për vetëmbrojtje dhe për të zgjedhur vetë fatin e saj.

4. Aktorët autoritarë sfidojnë interesat, vlerat dhe parimet tona demokratike duke përdorur mjete të shumta politike, ekonomike, teknologjike dhe ushtarake.

5. Ne jetojmë në një epokë të konkurrencës strategjike në rritje. Vetëbesimi dhe politikat në rritje të Kinës paraqesin sfida që ne duhet t'i adresojmë.

6. Konflikti i vazhdueshëm, brishtësia dhe paqëndrueshmëria në fqinjësinë tonë evropiane minojnë sigurinë tonë dhe ofrojnë terren pjellor për konkurrentët strategjikë, si dhe grupet terroriste, që të fitojnë ndikim, të destabilizojnë shoqëritë dhe të përbëjnë një kërcënim për sigurinë tonë.



7. Siç nënvizohet si nga Koncepti Strategjik i NATO-s ashtu edhe nga Busulla Strategjike e BE-së, ky është një moment kyç për sigurinë dhe stabilitetin euroatlantik, duke demonstruar më shumë se kurrë rëndësinë e lidhjes transatlantike, duke bërë thirrje për një bashkëpunim më të ngushtë BE-NATO.

8. NATO mbetet themeli i mbrojtjes kolektive për aleatët e saj dhe thelbësor për sigurinë euroatlantike. Ne e njohim vlerën e një mbrojtjeje evropiane më të fortë dhe më të aftë që kontribuon pozitivisht në sigurinë globale dhe transatlantike dhe është plotësuese dhe e ndërveprueshme me NATO-n.

9. Partneriteti ynë strategjik, përforcues, reciprok kontribuon në forcimin e sigurisë në Evropë dhe më gjerë. NATO dhe BE luajnë role plotësuese, koherente dhe reciprokisht përforcuese në mbështetjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Ne do të mobilizojmë më tej grupin e kombinuar të instrumenteve që kemi në dispozicion, qofshin ato politike, ekonomike apo ushtarake, për të ndjekur objektivat tona të

përbashkëta në dobi të një miliard qytetarëve tanë.

10. Duke u mbështetur në Deklaratën e Përbashkët të Varshavës 2016 dhe Deklaratën e Përbashkët të Brukselit 2018, e cila zgjeroi ndjeshëm gjerësinë dhe thellësinë e partneritetit tonë të krijuar më shumë se njëzet vjet më parë, ne kemi arritur përparim të paprecedentë në të gjitha fushat e bashkëpunimit.

11. Ne kemi arritur rezultate të prekshme në luftën kundër kërcënimeve hibride dhe kibernetike, bashkëpunimin operacional, duke përfshirë çështjet detare, lëvizshmërinë ushtarake, aftësitë e mbrojtjes, industrinë e mbrojtjes dhe kërkimin, stërvitjet, kundër terrorizmit dhe ndërtimin e kapaciteteve të partnerëve.

12. Ndërsa kërcënimet dhe sfidat e sigurisë me të cilat përballemi po evoluojnë në shtrirje dhe përmasa, ne do ta çojmë partneritetin tonë në një nivel tjetër në bazë të bashkëpunimit tonë të gjatë. Ne do të forcojmë më tej bashkëpunimin tonë në fushat ekzistuese dhe do të zgjerojmë dhe thellojmë bashkëpunimin tonë për të trajtuar veçanërisht konkurrencën

gjeostrategjike në rritje, çështjet e elasticitetit, mbrojtjen e infrastrukturës kritike, teknologjitë në zhvillim dhe përçarëse, hapësirën, implikimet e sigurisë të ndryshimeve klimatike, si dhe manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit të huaj.

13. Me nënshkrimin e kësaj deklaratë, ne do të çojmë përpara partneritetin NATO-BE në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aleatët e NATO-s dhe shtetet anëtare të BE-së, në frymën e hapjes së plotë reciproke dhe në përputhje me autonominë vendimmarrëse të organizatave tona përkatëse dhe pa paragjykimë, ndaj karakterit specifik të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes të cilitdo prej anëtarëve tanë. Në këtë kontekst, ne e

shohim transparencën si vendimtare. Ne inkurajojmë përfshirjen sa më të plotë të Aleatëve të NATO-s që nuk janë anëtarë të BE-së në nismat e saj. Ne inkurajojmë përfshirjen sa më të plotë të anëtarëve të BE-së që nuk janë pjesë e Aleancës në nismat e saj.

14. Ne do të vlerësojmë progresin në baza të rregullta.

Nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 2023, në tre kopje.

Charles Michel
Presidenti i Këshillit Evropian
Ursula von der Leyen, Presidentja e Komisionit Evropian
Jens Stoltenberg, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut

NATO, e hapur për një angazhim konstruktiv me Kinën

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s takohet me ambasadorin e ri kinez

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană priti ambasadorin Fu Cong, shef i Misionit Kinez në BE, në selinë e NATO-s në Bruksel, për herë të parë, më 10 janar 2023. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm dhe Ambasadori Cong diskutuan prioritetet për angazhimin NATO-Kinë, duke përfshirë dialogun për ndryshimin e klimës dhe kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje se NATO mbetet e hapur për një angazhim konstruktiv me Kinën, duke përfshirë shkëmbimin e pikëpamjeve për politikat përkatëse dhe ndërtimin e transparencës reciproke. Duke iu drejtuar luftës brutale të Rusisë kundër Ukrainës, zoti Geoană i bëri thirrje Kinës që të dënojë veprimet e paligjshme të Rusisë dhe goditjet e papërgjegjshme bërthamore. Ai ngriti shqetësimet e NATO-s për aktivitetin ushtarak të Kinës pranë Tajvanit. Ai gjithashtu i kërkoi Kinës që të angazhohet në mënyrë domethënëse në dialog, ndërtimin e besimit dhe masat e transparencës në lidhje me modernizimin e saj ushtarak dhe aftësitë dhe doktrinën bërthamore.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm u takua rregullisht me ish-shefin e misionit kinez në BE, ambasadorin Zhang Ming, për të diskutuar marrëdhëniet NATO-Kinë dhe sfidat ndërkombëtare të sigurisë.



NATO, BE dhe SHBA konsultohen për zhvillimet në Kosovë, Ballkanin Perëndimor

KFOR-i mbetet jashtëzakonisht vigjilent dhe ka aftësinë dhe personelin për të vazhduar zbatimin e mandatit të tij të OKB-së

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm, Mircea Geoana, priti në selinë e NATO-s, më 9 janar 2023, Zëvendës Ndihmës Sekretarin e SHBA-së, Gabriel Escobar dhe Përfaqësuesin Special të BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajčák. Takimi i tyre ishte pjesë e konsultimeve të rregullta për situatën në Kosovë dhe zhvillimet në rajonin e gjerë të Ballkanit Perëndimor.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Geoana theksoi përpjekjet intensive të kryera nga aleatët e



NATO-s dhe Bashkimi Evropian për të zbutur tensionet e fundit, veçanërisht në veri të Kosovës. Ai gjithashtu nënvizoi mbështetjen kryesore të ofruar nga misioni i KFOR-it të udhëhequr nga NATO dhe misioni i Sundimit të Ligjit (EULEX) i udhëhequr nga BE-ja në çmontimin e suksesshëm të postbloeve, të cilat kanë ndihmuar në rivendosjen e plotë të lirisë së lëvizjes në mbarë Kosovën.

KFOR-i mbetet jashtëzakonisht vigjilent dhe ka aftësinë dhe personelin për të vazhduar zbatimin e mandatit të tij të OKB-së plotësisht dhe në baza ditore, për të mirën e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Kjo i

kontribuon sigurisë në Kosovë dhe stabilitetin në të gjithë rajonin. NATO gjithashtu vazhdon të mbështesë dialogun e lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, si platforma kryesore për të ndërtuar paqen dhe sigurinë e qëndrueshme në të gjithë rajonin, dhe të gjitha përpjekjet që synojnë avancimin e integritetit evropian dhe euroatlantik të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë vizitës së tyre, z. Escobar dhe z. Lajčák informuan gjithashtu ambasadorët e NATO-s për përpjekjet dhe angazhimet e tyre diplomatike reciprokisht përforcuese me të gjitha palët në rajon.



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

RRUGËTIMI I POLICISË 110-VJEÇARE TË SHTETIT SHQIPTAR

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe zgjedhja e organeve ekzekutive dhe legislative të shtetit ishin aktet subline në 1912-tën. Kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali, bëri njoftimin e gjashtë Fuqive të Mëdha: Anglinë, Italinë, Austro-Hungarinë, Francën, Gjermaninë dhe Rusinë, për këtë akt madhor të shqiptarëve. Njof-tuan gjithashtu dhe shtetet ballkanike si: Rumania, Mali i Zi, Serbia, Bullgaria, Greqia e Turqia, duke u kërkuar njohjen e pavarësisë, si rrjedhojë e natyrshme e vullnetit të shqiptarëve. Më 28 nëntor, Ismail Qemali u shpall kryetar i Kuvendit dhe kryetar i parë i qeverisë së shtetit shqiptar. Pavarësia u shpall për të gjitha trojet shqiptare dhe ministrat u zgjodhën nga të gjitha trevat shqiptare. Pavarësia si akt madhor përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e shqiptarëve, fryt i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të të gjithë shqiptarëve, për të mbrojtur tërësinë tokësore dhe për të formuar shtetin e pavarur shqiptar. Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës. Vetëm një javë më vonë u formata qeveria, ndërkohë që nevojë imediate ishte rendi, qetësia dhe siguria e brendshme. Struktura e qetësisë ishte një prej obligimeve të para të qeverisë së Vlorës. Ndjenja patriotike e shqiptarëve ishte pishtari i ndezur i atdhetarisë për t'u mbrojtur nga rreziqet. Policia e Shtetit është struktura që e kërkon koha në të gjitha epokat. Krijimi i policisë së shtetit për herë të parë u bë bazuar në vizionin e themeluesit të shtetit, i cili në ditët e para të vitit 1913 thoshte: "Përpikuni të siguron sa më mirë qetësinë e vendit dhe rendin publik...", "Duhet pra, ... të mësohet puna e xhandarmërisë dhe e policisë në duar të ndershme dhe të stërvitura, të zgjidhni xhandarë dhe policë me kujdes të madh dhe të një rregull të shtrënguar!". Porosia e kryeministrit Ismail Qemali ishte për gjithë prefekturat dhe bashkitë. Për herë të parë në një qeveri shqiptare nisi të funksiononte Zyra e Sigurimit Publik, që thënë ndryshe ishte Drejtoria e Policisë Shqiptare, me detyra administrative dhe gjurmuese, ndërkohë që shkollimi ngeli një ide në letër. Kështu, më 13.1.1913, Qeveria e Vlorës mori vendimin për krijimin e Forcave të Rendit, të Policisë dhe Xhandarmërisë, (DPAQSH. Fondi dokumentar 245/II, dosja 69, faqe 1). Detyrat e forcave të rendit, që rridhnin nga Kuvendi i Vlorës, do t'i kryente një xhandarmëri me Alem Tragjasin, Hysni Toskën, Sali Vranishtin dhe Hajredin Hekalin, ndërsa në funksionin administrative policor, drejtor i parë ishte Halim Gostivari. Më 4.5.1913 u krijua Shtabi Madhner, nga i cili varej xhandarmëria me tre batalionet e saj të Vlorës, Beratit dhe Elbasanit, ndërsa më 3.6.1913 u miratua "Rregullorja e Milicisë shqiptare të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës". Në një periudhë kohore 110-vjeçare, Policia e Shtetit ka pasur historikun e saj të zhvillimit, në përputhje me politikat shtetërore



të paqëndrueshme. Policia ka qenë dhe ka ngelur domosdoshmëri jetike e shtetit dhe kërkesë e publikut, për misionin principial që policia luan në shërbim të rendit, qetësisë, sigurisë, komunitetit si dhe në zbatueshmërinë ligjore. Organizimi i parë i Policisë u bë në bazë drejtorie me qendër në Vlorë. Drejtuesi i parë i policisë shqiptare në shtetin e Ismail Qemal bej Vlorës ishte Halim Jakova – Gostivari (1878-1927) nga Gjakova, ndërsa pas tij Fehmi Mezhgorani nga Tepelena. Në planin historik Policia Shqiptare është ngritur nga vetë shqiptarët dhe më vonë edhe është mbështetur e këshilluar nga ekspertë e specialistë holandezë e më tej edhe britanikë, edhe pse është ruajtur tiparet dhe identiteti i misionit civil të Policisë, formati i europian, por dhe me norma juridike për gjurmimin, hetimin, arrestimin, mbrojtjen e të drejtave e të lirisë të individit, ndalimet e hyrjeve me forcë në shtëpitë e qytetarëve, grumbullimet pa armë etj.

Përvoja botërore e policimit dhe policimi në filesat e shtetit shqiptar

Shqiptarët kishin detyra më imediate për sigurinë e shtetit, se sa reformimi mbi bazën e eksperiencave botërore të policimit. Ndërkohë që bota e përparuar kishte bërë reforma të shumta për policim në vendin tonë rithemelimi i shtetit dhe policimi formal. Bota e përparuar njihje tashmë një emër të njohur Robert Peel, nismëtar për miratimin mbretëror Britanik të Aktit të Policisë Londineze më 19.06.1829, duke vendosur policinë e Londrës nën kontrollin e Sir Robert Peel, ishte një zgjidhje për shkak të frikës së publikut në lidhje me vendosjen e forcave të ushtrisë në çështjet e brendshme. Ai ishte i pari Sekretar i Brendshëm në botë që organizoi forcën policore përgjatë linjave civile, në vend se forcave paramilitare. Për t'u dukur neutrale,

uniforma ishte porositur dhe prodhuar qëllimisht në ngjyrë blu, sesa e kuqe, e cila ishte atëherë një ngjyrë ushtarake, së bashku me oficerët të armatosur vetëm me një shkop druri dhe një raketë për të sinjalizuar nevojën për ndihmë në rast rreziku. Së bashku me këtë, radhët e policisë për kohën nuk përfshinin tituj ushtarakë, me përjashtim të gradës së rreshterit. Forca policore prej 1000 djemsh, ose sikurse quheshin "Bobsat", për nder të krijuesit të tyre, Robertit, nuk mbante armë zjarri, megjithëse Sir Robert Peel autorizoi Komisionerin të blinte pesëdhjetë pistoleta xhepi, për t'u përdorur në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë ato që përfshinin përdorimin e armëve të zjarrit. Karakteristikat e "bobsave" në sytë e publikut ishin "helmeta, shkopinjë dhe bilbili". Në atë kohë, në Londër dhe jo vetëm vjedhjet ose thyerjet e shtëpive, ishin një problem i zakonshëm për policinë. "Shkelësit e shtëpive" ishin zakonisht të armatosur. Atëherë ishte gjithashtu e ligjshme (sipas projektligjit të të drejtave, 1689) për anëtarët e publikut që ishin protestantë, siç ishin shumica, të zotëronin dhe të përdorin armët e zjarrit. Pas vdekjes së oficerëve me armë zjarri, në rrethet e jashtme të metropolit dhe debatit publik për armatosjen e forcës, Komisioneri i kërkoi Robert Peel për autorizim për të furnizuar oficerët në rrethet e jashtme me revolverë. Autorizimi u dha me kushtin që revolverët të lëshoheshin vetëm nëse, sipas mendimit të oficerit të lartë, oficerit mund t'i besohej ta përdorte me siguri dhe me përgjegjshmëri të lartë. Robert Peel në mendjen e njerëzimit ka ngelur si "babai" i policisë së botës. Eksperiencat britanike u përhapën në mbarë botën. Era e policimit mbërriti deri në Shqipërinë tonë të vogël, por me aspirata të mëdha të shtet-formimit. Së pari, me tiparet e policimit janë grupi i xhandarmërisë holandeze me Gjeneral De Veerin

dhe kolonel Tomsonin, ndërkohë që pas viteve '20-të, vështrimi u hodh edhe përtej kufirit administrativ shqiptar. Në maj 1923 Kolonel Frank Sterling mbërriti në Shqipëri. Ndërsa më 29.9.1926, vendin e inspektorit të përgjithshëm, që mbante gjenerali anglez Frank W Sterling e zuri gjenerali anglez Xhozelin Persi (1871-1952). Më 1933, në krye të Xhandarmërisë ishte nënkolonel Shefki Shatku, i cili ishte një nga oficerët më të përgatitur të kohës, por në të njëjtën kohë, mbretëria e brishtë shqiptare në ndihmë të Xhandarmërisë, kishte vendosur në dispozicion gjeneralmajorin anglez në pension Sir Jocelyn Percy. Policimi në Shqipëri kishte kaluar edhe në "rrugë të pashkelura", që misionin e policimit e kryente Garda dhe Xhandarmëria shqiptare, si elemente të sigurisë së brendshme deri në prillin e '39-ës, kur pushoi së ekzistuari. Misioni i policimit i Xhandarmërisë shqiptare, më 1936, kishte një kolonel, katër nën/kolonelë, 8 majorë, 16 kapitenë të parë, 32 kapitenë të dytë, 40 togerë, 43 nëntogerë, me 144 oficerë gjithsej me 3.250.000 franga ari buxhet të përgjithshëm. Në këtë periudhë pati përpjekje që policimi shqiptar të institucionalizohej përmes çeljes së kursit të policor më 21.5.1938, pararendëse e arsimimit policor në vendin tonë.

Policimi në periudhën e pavarësisë së dytë të Shqipërisë

Vitet '20-të janë ndër më decizivët për ardhmërinë e shtetit shqiptar. Kongresi i Lushnjës, Lufta e Vlorës dhe sidomos pas konferencës së Versajës, shqiptarët kaluan ndër momentet më të rëndësishme historike të shtet-formimit. Në vitet 1919-1920, qeveria vlerësoi rëndësinë e Policisë. Ajo organizoi Drejtorinë e Përgjithshme të Qetësisë Botore dhe u dha kompetenca nënprefekturave e prefekturave që të organizojnë zyrat e Policisë dhe të caktojnë

policët në detyrë. Strukturat e Policisë në atë kohë u shtrinë në 14 nënprefektura, që kishte një efektiv prej 5 komisarësh, 8 nënkomisarë, 43 policë, që ishin emërtuar "komiseri". Ishte hera e parë në historikun e saj që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë pati buxhetin e saj, që në nëntor 1919, buxhet i cili u rrit më tej më 1920, në masën 30%. Paga e punonjësve të policisë shënonte rritje me argumentin se do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes dhe rritjen dhe ndërgjegjësimin e policëve të shtetit të riformuar shqiptar. Viti 1920-të ishte viti i riorganizimit të Policisë shqiptare me drejtori policie në prefektura dhe shtimin e limitit organik të saj. Drejtorë të rinj të policisë dhe komisarë policie të rinj ishin sikurse administratorët vendorë e drejtuesit në strukturat e xhandarmërisë, ushtrisë e milicisë. Më 1921-shin roli i Policisë u fuqizua dhe iu kushtua kujdes i posaçëm i aftësisë për kryerjen e veprimeve procedurale që në çastin e njoftimit për ngjarjen, ndjekjen me shumë përgjegjësi të ngjarjeve kriminale dhe dokumentimin rigoroz të tyre në një raport në çdo dy javë. Kontrolli i territorit ishte detyrë e rëndësishme dhe në metodën e policimit u kufizua e drejta e veprimit arbitrarisht ndaj individëve.

Policimi në vitet e Republikës së parë, Mbretërisë dhe policisë popullore

Në vitet 1927, 1928 në vendin tonë kishte përpjekje për organizimin e Policisë Shqiptare sipas modelit italian dhe në zbatim të ligjit për Administratën Civile, duke synuar dhënien e të gjithë kompetencave prefektit për kontrollin e policisë. Në dhjetëvjeçarën 1928-1938 ka pasur zhvillime progresive të policisë e xhandarmërisë, ku futen elementë modernë perëndimor në fushën e strukturave dhe legjislacionit të policisë dhe xhandarmërisë. U krijuan për herë të parë disa lloje policish, si policia bashkiake më 1928, policia rurale më

1929, policia kufitare më 1930, policia e sigurimit publik më 1938, roja mbretërore e kufirit më 1939 dhe xhandarmëria qytetase me atributet e policisë urbane, etj. Periudha e viteve 1939-1944 ishte në peshën e LIIB, ndërsa Policia në më të shumtën ishte strukturë e qetësisë e rendit në rrethana specifike të luftës. Fillimisht ajo ishte pjesë e trupës së armatosur e Policisë në Shqipëri, në varësi të kryesisë së Këshillit të Ministrave, por e inkorporuar në trupën policore të Mbretërisë së Italisë. Në strukturën organizatave të saj spikat Drejtoria Qendrore e Sigurimit Publik, zyrat e prefekturave, zyrat në nënprefektura dhe zyrat e kufirit dhe të post-porteve tokësore e detare. Gjatë LIIB strukturat e policisë e xhandarmërisë në pjesën me të madhe u asimiluan dhe u profilizuan sipas interesave të shteteve pushtuese. Gjatë dy pushtimeve, policia u integrua në strukturat ushtarake me emërtimin "Trupa e Armatosur e Policisë". Në vitin 1943, në zonat e çliruara, u krijuan strukturat partizane për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike: Komandat e Qarkut, Komandat e Vendit dhe rojet vullnetare. Pas Luftës së Dytë Botërore organizimi dhe strukturimi i policisë është bërë sipas modeleve lindore. Për periudhën e pushtimit Italian policia ishte në mbikëqyrjen e këshilltarit të përhershëm të policisë italiane dhe shumë funksionarëve të tjerë italianë, ku kjo periudhë pati fuqizim të policisë dhe rritje të gamës së përgjegjësisë të saj. Çlirimi nga pushtimi nazifashist i vendit solli politika të reja në misionin dhe funksionin e policisë. Bërthamat e njësive policore të krijuara në zonat e çliruara gjatë luftës ishin të gatshme të merrnin përgjegjësinë e mbajtjes së qetësisë në vend. Më 14.5.1945 u bë riorganizimi zyrtar i ri i policisë, për gjithë strukturat ushtarake të komandave të qarqeve dhe njihet si krijimi i Policisë Popullore, si strukturë e MPB, që varej nga Drejtoria e Policisë dhe në periudhën 1946-1948 limiti organik ka variuar nga 2286 deri në 3766 vetë. Deri më 1982 limiti organik i Policisë së Shtetit ka qenë i pandryshueshëm në shifra, ndërsa zhvillimet ndërkombëtare dhe ato të brendshme ndikuan në rritjen e limitit organik të Policisë aq sa në vitin 1991 shifra e punonjësve të rendit e të qetësisë arriti në kufijtë deri 21 000 punonjës. Në fillimin e këtyre viteve kanë zanafillën krijimin e strukturave të forcave speciale, shtimi i masave të shumta të sigurisë për VIP-at dhe sidomos rritja e numrit të policisë kufitare.

Era e policimit dhe sigurisë së brendshme në demokracinë shqiptare

Periudha 1992 e në vijim u shoqërua me reformimin e strukturave, personelit, standardeve të policimit dhe përmirësimin e ndjeshëm të infrastrukturës. Nëse bëjmë bilancin e rrugëtimit 110-vjeçar të Policisë Shqiptare, së pari kemi obligimin moral e shpirtëror të përulëmi në shenjë të thellë nderimi e respekti para varrezave, lapidarëve, memorialëve të punonjësve të Policisë, të rënë në krye të detyrës në emër të sakrificës sublime, në përmbushje të misionit ligjor, për të garantuar rendin e qetësinë publike në Shqipëri, sepse "gjaku i policisë është gjak i shtetit". Në një shekull e dhjetë vite të ekzistencës së Policisë shqiptare vlen shumë nderimi dhe vlerësimi i pjesëmarrësve të ndershëm të Policisë, të gjithë ata që kontribuan dhe sakrifkuan në përbashkësi me elementët kriminalë, në çdo skaj të atdheut, larg familjeve, në kushte jo të favorshme pune e jetese por me bindjen e brendshme

dhe pasionin e lartë për t'i shërbyer me rigorozitet ligjit, mbrojtjes së jetës së qytetarëve me jetën e tyre dhe garantimit të të ardhmes së qetë e të sigurt në Shqipëri. Policia Shqiptare është në krah të policive moderne evropiane, pse jo, e barabartë dhe në frontin e përbashkët kundër krimit të të gjithë llojeve të tij. Policia sot ka të gjitha potencialet intelektuale e profesionale të Policisë Shqiptare, janë të nivelit dhe standardeve që sigurojnë efikasitet të lartë në përmbushjen e misionit të saj, në përmbushje të kryerjes së detyrimeve ligjore e profesionale të përgjegjësive, si në fushën e krimit të organizuar ashtu edhe në atë të policimit në tërësi. Policia e Shtetit sot ka një bazë të sigurt të arsimit modern, të kualifikimit dhe trajnimeve që është Akademia e Sigurisë tashmë edhe e akredituar zyrtarisht nga viti 2022 e në vijimësi. Këtu vlen të përmendim edhe një bashkëpunim të nivelit bashkëkohor me finlandezët, estonezët, austriakët, italianët etj. Në ligjin për Policinë e Shtetit, nr. 108/2014, në nenin 37, parashikohet që Policia të ketë institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ e menaxherial. Në zbatim të këtij neni, me VKM nr. 185 datë 25.2.2015, u krijua Akademia e Sigurisë, tashmë përgjegjëse edhe për edukimin dhe trajnimin e punonjësve të strukturave të tjera të sigurisë në vend. AS-ja ka në dispozicion edhe një Qendrën Kërkimore Shkencore dhe të Projekteve, që ka realizuar disa projekte kërkimore shkencore, konferenca shkencore ndërkombëtare e kombëtare, ka publikuar 28 revista shkencore "Policimi dhe Siguria". Ndërkohë që institucioni unik i Akademisë së Sigurisë po punon fort për përmbushjen e misionit dhe të vizionit, ku veprimtaria në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor është vlerësuar në vazhdimësi nga publiku dhe autoritetet më të larta të ekzekutivit e legjislativit. Misioni themelor i Akademisë së Sigurisë është zhvillimi dhe transmetimi i dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe sigurisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera ligj-zbatuese. Strukturat e vartësisë akademike si FSH-ja, KPFP-ja dhe QKSHP-ja, janë aset dhe domosdoshmëri për përmbushjen me sukses të detyrimeve në Policinë e Shtetit, për ardhmërinë e sigurt të luftës ndaj krimit, për rendin dhe sigurinë në vend. Arsimimi policor është futur në hollinë e plotë të aplikimit të ligjit të arsimit të lartë dhe ligjit të policinë e shtetit në një sinkron eksplicit dhe mirëkuptues institucional. Policia e Shtetit është plotësisht e inkurajuar nga partnerët ndërkombëtarë, është në bashkëpunim të ngushtë me shumë institucione ligj-zbatuese dhe ka standarde por dhe kapacitete të mjaftueshme për realizuar mjeshtërisht metodat më bashkëkohore të hetimit si dhe disponon teknologjinë e informacionit e aplikon sistemet bashkëkohore në strukturat deizive të policimit. Policia e Shtetit meriton nderim e mirënjohje edhe në këtë 110-vjetor të rrugëtimit përmes flakëve të përzhitura të krimit dhe triumfeve mbi vështirësitë, duke shpalosur profesionalizmin, vlerat e larta njerëzore. Policia, djemtë dhe vajzat e popullit nga të gjitha trevat e Republikës meritojnë padyshim falënderimet e përzemërta, sepse janë mbrojtësit e garantuesit e jetëve njerëzore, në shërbim të qytetarit, të ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike, në zbatimin rigoroz të ligjit.

"FIDANISHTJA SKËNDERBEGASE"

IN MEMORIUM

Flamur Bërdëllima: "Mbi pllakën e varrit të më shkruhet se kam jetuar vetëm 4 vjet jetë, ato të shkollës 'Skënderbej'"

Më 18 janar 2022, në moshën 68-vjeçare, ndahet nga jeta, familja, miqtë publicisti Flamur Bërdëllima, skënderbegasi që dashuroi çdo gurë të kësaj shkolle.

Skënderbegasi Flamur Bërdëllima, publicist dhe sportist i njohur, ishte dhe mbetet një ndër personazhet më karizmatik e të dashur, jo vetëm për ata që kanë kryer Shkollën Ushtarake "Skënderbej" në brezin e tij, por dhe për breza të tjerë e publikun shqiptar. Ai është autor i shumë librave të botuar, gazetar profesionist në shumë vite dhe aktivist i njohur shoqëror.

Flamur Bërdëllima u lind më 14 janar të vitit 1954 në Tiranë. Pas përfundimit të arsimit 8-vjeçar në kryeqytet, Flamuri nisi studimet në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" në Tiranë, në vitin 1979. Ai ishte jo vetëm nxënës i mirë, por njëkohësisht edhe një basketbollist i shquar, që arriti deri në formacionet e ekipit të njohur të "Partizanit".

Krahas arsimit ushtarak, Flamur Bërdëllima ka kryer dhe Fakultetin e Histori-Filologjisë së Universitetit Shtetëror të Tiranës, Fakultetin Ekonomik, dega Plan, po në këtë universitet, kursin njëvjeçar pasuniversitar të Historisë, kursin pasuniversitar të Psikologjisë dhe kursin pasuniversitar të Filozofisë.

Ka titullin shkencor "Kandidat i Shkencave Historike". Ka këto eksperiencë pune: minator në sektorin Mushqeta; mësues në rrethin e Pukës; instruktor në Bashkimet Profesionale të rrethit Tiranë, Rajoni nr. 2; gazetar në gazetën "Pasqyra"; drejtor i Shtëpisë së Pionierit, Kombinat në Tiranë. Në veprimtarinë intelektuale ka me mijëra artikuj gazete, telereportazhe, dokumentarë televiziv, emisione në radio dhe është autor i 15 librave artistik. Fliste turqisht, anglisht dhe frëngjisht.

Pak 'jetë' nga jeta e Flamur Bërdëllimës

Kujtime nga Shkolla "Skënderbej"

"...Unë kam lënë një amanet, që kur të vdes, mbi pllakën e varrit të më shkruajnë: "Flamur Bërdëllima. Ka jetuar vetëm 4 vite jetë, ato të shkollës 'Skënderbej', vitet e tjera kanë qenë zi e më zi!"

Shkolla Ushtarake "Skënderbej", në të cilën unë studiova e u arsimova katër vite, ka qenë një vatër e dashur, e ngrohtë, një shkollë ku shkollimi e edukimi ishin jo vetëm cilësor, por dhe kalisnin tek nxënësi vullnetin, ndërgjegjen, vëllazërinë e shpirtmirësinë. Sigurisht, si çdo njeri, dhe unë kam pasur në jetë gëzime e hidhërime, suksese e dështime, por ato vite mbeten vite të arta... Kur vajta skënderbegasi, unë mësoja, por dhe jetoja shumë. Kjo për shkak të gjendjes së vështirë familjare, pasi dhe babanë e kisha me sëmundje të rëndë, nga e cila u nda shumë shpejt nga jeta. Gjithë ditën mësoja e studioja, ndërsa gjatë gjithë natës punoja si hamall



ngarkim-shkarkimi makinash, ku siguroja ndonjë të ardhur për familjen. Në mëngjes, kur të tjerët çoheshin nga gjumi, unë gjendesha në shkollë e kryeja orarin ditor të veprimeve bashkë me 'ta. Përveç disa shokëve, këtë e dinte dhe komandanti Tosun Alushi, por kurrë ai nuk foli për këtë shkelje që bëja unë. Pra, në këtë shkollë, përveç arsimit, gjeta një kolektiv shokësh të mrekullueshëm të cilët nuk mund të harrohen kurrë. Ishin shokë të vitit tim, por dhe të viteve më pas apo dhe para meje... Dhe sot, kur kanë kaluar më shumë se katër dekada e gjysmë, kur takohemi, takohemi me mall e nostalgji, me të gjithë skënderbegasit, me mësuesit e mësueset tona të mira, me komandantët dhe komisarët e dikurshëm. Është mall e dashuri e një jete të mrekullueshme, ku kishte vlerën maksimale fjala shoqëri, vëllazëri e fjala Njeri. Sot në këto kohë të egra, kur e keqja mbizotëron mbi të mirën, koha e Shkollës Ushtarake "Skënderbej", është një leksion mirësie e dashurie të munguar jo vetëm për ne skënderbegasit, por për gjithë shoqërinë shqiptare që po lëngon aq shumë sot..."

Përkujtojmë me respekt rrugëtimit plot sfida të skënderbegasit Flamur Bërdëllima.

Qoftë udhëtim i qete ai në parajsë, oazi që i takon njerëzve të mirë, si ju!

**Kujtim Boriçi
Maksim Fajzullai**

Nis cikli i parë i bashkëpunimit dhe monitorimit për të arritur objektivat e Dekadës Dixhitale të BE-së 2030

Programi i politikave të Dekadës Dixhitale 2030, një mekanizëm monitorimi dhe bashkëpunimi për të arritur objektivat e përbashkëta për transformimin dixhital të Evropës deri në vitin 2030, ka hyrë në fuqi.

Për herë të parë, Parlamenti Evropian, Shtetet Anëtare dhe Komisioni kanë vendosur së bashku objektiva dhe objektiva konkretë në katër fushat kryesore të aftësive dixhitale, infrastrukturës duke përfshirë lidhjen, dixhitalizimin e bizneseve dhe shërbimet publike online, në lidhje me Deklaratën mbi Të Drejtat dhe Parimet Dixhitale Evropiane. Objektivat dhe shoqërohen nga një proces ciklik bashkëpunimi duke filluar që sot, për të vlerësuar progresin dhe për të përcaktuar piketa në mënyrë që ato të mund të arrihen deri në vitin 2030. Programi gjithashtu krijon një kornizë të re për projektet shumë-vendëshe që do t'u lejojë Shteteve Anëtare të bashkohen forcat për iniciativat dixhitale. Zëvendës-Presidentja Ekzekutive për Një Evropë të Përshtatshme

për Epokën Dixhitale, Margrethe Vestager, tha: "Teknologjia do të vazhdojë të luajë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në shoqëritë tona dhe në jetën tonë. Me mekanizmin e monitorimit ne tani kemi synime konkrete se si ta bëjmë teknologjinë dixhitale të funksionojë për të gjithë njerëzit dhe për bizneset."

Komisioneri për Tregun e Brendshëm, Thierry Breton, tha: "Është e rëndësishme që Evropa të përqafojë Dekadën Dixhitale për të siguruar që transformimi ynë dixhital të jetë i suksesshëm. Për ta arritur këtë, ne duhet t'i japim përparësi zhvillimit të inxhinierëve shumë të aftë, rritjes së lidhjes në të gjithë kontinentin dhe përmirësimit të infrastrukturës për SME-të tona. Duke u fokusuar në teknologjitë kryesore si 5G, kompjuteri në re, kompjuterike, rrjetet me fibra optike, llogaritja kuantike dhe mikroelektronika, ne do të punojmë me Shtetet Anëtare për të arritur qëllimin tonë për elasticitet dhe autonomi deri në vitin 2030."



Migrimi për motive punësimi: Komisioni dhe Shtetet Anëtare rrisin bashkëpunimin për të trajtuar mungesat në tregun e punës të BE-së

Komisionerja për Çështjet e Brendshme, Ylva Johansson dhe Komisioneri për Punë dhe të Drejtat Sociale, Nicolas Schmit, mirëpritën ekspertët e migracionit dhe punësimin nga shtetet anëtare të BE-së në takimin e parë të Platformës së Migracionit të Punës në Bruksel. Platforma është krijuar për të avancuar migrimin për motive punësimi nga vendet e treta në BE dhe për të siguruar që ai të menaxhohet mirë dhe të synohet aty ku janë nevojat për fuqi punëtore dhe aftësi. Platforma e re bashkon Komisionin dhe përfaqësuesit nga Shtetet Anëtare të specializuar në politikat e migracionit dhe punësimin për të nxitur bashkëpunimin e ngushtë midis dy sektorëve, si dhe midis Shteteve Anëtare dhe BE-së për të mbështetur operacionalizimin efektiv të iniciativave të nivelit të BE-së për migrimin legal dhe punësimin. Nisja e Platformës është një iniciativë e Paketës së Aftësive dhe Talenteve dhe do të mbështesë objektivat dhe veprimet e vitit të propozuar të aftësive 2023.

Komisionerja për Çështjet e Brendshme, Ylva Johansson, tha: "Tërheqja e njerëzve të aftë dhe të talentuar nga vendet jo anëtare të BE-së në tregun e punës të BE-së është në axhendën tonë të lartë, pasi shumë kompani në BE po luftojnë për të gjetur punëtorë me aftësitë e nevojshme. Për të qenë ndërfituesit në garën globale për talent, ne duhet të zhvillojmë dhe përshtatim vazhdimisht politikën e migracionit legal të BE-së. Platforma e re e migracionit për motive punësimi na lejon të ndërtojmë përvojat dhe praktikatat më të mira të Shteteve Anëtare në migrimin për motive punësimi dhe të përdorim ekspertizën e sektorëve të migracionit dhe punësimin." Komisioneri për Punë dhe të Drejtat Sociale, Nicolas Schmit, tha: "Shumë kompani në BE luftojnë për të gjetur punëtorë me aftësitë e nevojshme. Migrimi i synuar për motive punësimi i kombinuar me një politikë aktive integruese është një përgjigje për këtë sfidë. Kjo platformë e re do të ndihmojë Shtetet Anëtare të trajtojnë mungesat e fuqisë punëtore në sektorët kyç, duke përfshirë tranzicionin e gjelbër dhe atë dixhital. Në të njëjtën kohë, ai do të mbështesë njerëzit nga jashtë BE-së për të gjetur një punë cilësore këtu, duke u mbështetur në aftësitë që kanë dhe për të mësuar aftësi të reja. Sigurimi i kushteve të drejta dhe të mira të punës për të gjithë duhet të mbetet prioriteti ynë në këtë kontekst."

Shtetet anëtare po përballen me



mungesë të fuqisë punëtore dhe aftësive, për shembull në sektorët e kujdesit shëndetësor dhe teknologjisë së informacionit. Një fuqi punëtore e kualifikuar është çelësi për të siguruar konkurrencën në të ardhmen dhe për të shfrytëzuar sa më shumë mundësitë e tranzicionit të gjelbër dhe dixhital. Për shkak të tendencave aktuale demografike që çojnë në një plakje dhe tkurrje të popullsisë së punës në BE, këto mungesa do të rriten në të ardhmen. Një masë që mund të kontribuojë për të kapërcyer këtë sfidë është migrimi i mirë-menaxhuar për motive punësimi.

Në këtë takim, pjesëmarrësit, duke përfshirë partnerët ekonomikë dhe socialë, diskutuan sfidat e tregut të punës dhe mundësitë e migrimit për motive punësimi për të ndihmuar në trajtimin e tyre. Ata gjithashtu shkëmbyen pikëpamjet dhe praktikatat më të mira në lidhje me mjetet më efektive për të tërhequr njerëz të aftë dhe të talentuar në BE. Për të çuar përpara përpjekjet e përbashkëta, Komisioni dhe Shtetet Anëtare po përdorin platformën për të mbështetur operacionalizimin e iniciativave të nivelit të BE-së për migracionin dhe punësimin legal, të tilla si grupi i ardhshëm i talenteve të BE-së dhe Partneritetet e talenteve të BE-së, të dyja të përshkruara në Paketën për Aftësitë dhe Talentet e Komisionit.

Platforma e Migracionit për motive

punësimi do të takohet rregullisht për të rritur bashkëpunimin dhe përparimin në fushën e migrimit për motive punësimi në BE. Në varësi të temave të diskutuara, ekspertëve dhe organizatave përkatëse do t'u kërkohet të bashkohen përveç përfaqësuesve të Komisionit dhe të Shteteve Anëtare. Synimi do të jetë të mësojmë nga njëri-tjetri dhe të përparojmë së bashku.

